



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
18.03.2024			
057		650	



Erasmus+

**Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte e Universitetit Publik
"Kadri Zeka", në Gjiilan,**

shpall këtë:

**Thirrje për aplikime për shkëmbim të stafit
në Universitetin "Çukurova University" Adana,
Turqi**

Universiteti Publik "Kadri Zeka", është pjesë e projektit KA171 ICM, 2022-2027, Erasmus+, në partneritet me Universitetin e Çukurova University, Adana, Turqi.

Programi Erasmus + KA171 ose Shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i stafit (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit të Çukurova University nga Turqia dhe Universitetit "Kadri Zeka", në Gjiilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e stafit nga Universiteti "Kadri Zeka" – Gjiilan për studim dhe trajnim / veprimtari të lëvizjes në fusha të ndryshme, ku në këtë thirrje do të kenë mundësi që dy(2) staf të UKZ-së të realizojnë mobilitetin në Universitetin e Çukurova.

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti sipas Distance Calculator të Erasmus +:

<https://erasmus-plus.ec.europa.eu/resources-and-tools/distance-calculator>

Granti i udhëtimit do të paguhet pas lëvizjes nga projekti dhe mbulohet nga Universiteti pritës.

Shënim:

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.



APLIKIMI DHE PËRZGJEDHJA

Kriteret për aplikim për stafit janë:

Të jeni mësimdhënës i rregullt në UKZ apo në rast të stafit administrativ të keni kontratën valide të punës në UKZ.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kontrata e punës (që dëshmon që jeni staf i rregullt i UKZ-së, apo staf administrativ);
- CV në Gjuhën Angleze (ku janë të përmendura edhe punimet shkencore, si dhe të arriturat e tjera dhe përvoja e punës);
- Kopje e pasaportës (faqja që përmban emrin tuaj, foton dhe të dhënat personale) ose letërnjoftimit;
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Kërkohet njohuri e gjuhës angleze e dëshmuar;

Përzgjedhja bëhet:

- Në bazë të fushës së përafërt të ligjërimit me fushat e ofruara nga Universiteti prites 50% dhe fusha juaj e veprimtari në UKZ;
- Gjuhë e huaj 50%

PROCEDURA E APLIKIMIT

1. Aplikimet duhet të dorëzohen në zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar (kopje fizike), prej datave 18.03.2024 deri 27.03.2024;
2. Të gjithë aplikantët duhet të jenë në gjendje të sigurojnë dëshminë/ certifikatën e gjuhës angleze C1 të njohura ndërkombëtarisht si the TOEFL, the IELTS;
3. Aplikantët të cilët ishin pjesë e mobilitetit në të kaluarën nuk kanë përparësi ndaj aplikantëve të cilët aplikojnë për herë të parë në thirrje të llojit të tillë (ata do të kuotohen me pikë negative nga komisioni);
4. Rezultatet e aplikimit do të shpallen në www.uni-gjilan.net

Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.

Për çdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ.

Me respekt,

Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte